



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6589/2025

A.nr.1551/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1551/2025, të datës 07.08.2025, të parashtruar nga ankuesi M.I. i të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokate Rizona Hashani nga Obiliqi, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës” bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1551/2025, të datës 07.08.2025, të parashtruar nga ankuesi M.I.

A r s y e t i m

Ankuesi M.I. më datë 07.08.2025, përmes përfaqësues së autorizuar Av. Rizona Hashani, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar në shenjë A.nr.1551/2025, kundër Përgjigjes me Nr.prot.12-112/12-20515/25, të datës 27.07.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, për shkak të mos realizimit të pagës si Zyrtar i Lartë për Përkthime, me koeficient (5.8), ndërsa, i njëjti më datë 06.10.2025, përmes përfaqësueses së autorizuar ka tërhequr ankesën e datës 07.08.2025, me arsyetimin se ankuesi tashmë është pensionuar.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 06.10.2025 të ankuesit për tërheqje nga ankesa e parashtruar më datë 07.08.2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës A.nr.1551/2025, të datës 06.10.2025.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1551/2025

Kaltrina Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses të autorizuar të ankuesit: Avokate Rizona Hashani;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së